



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Primijeno/Prodato Received/Delivery	17.03.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SBICK	2784/2023		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.347/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.374/2023 të datës 10.02.2023, të parashtruar nga ankuesi

në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mabjtur më datë 17.03.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.374/2023 e datës 10.02.2023, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 10.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 1673/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Vendimit më numër protokollit 10 të datës 06.01.2023 të Komisionit Vlerësues për lëvizje në kategori në Agjencinë e Punësimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 20.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencinë e Punësimit. Ndërsa, Këshilli me datë 28.02.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1673/2023 të datës 10.02.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër të protokollit 10 të datës 06.01.2023 të Komisionit për Vlerësimin për Lëvizje Brenda Kategorisë në Agjencinë e Punësimit; Ankesën me numër të protokollit 07/23 të datës 04.01.2023; Njoftimin me numër të protokollit 308 të datës 28.02.2022 të Zv.Udhëheqëses së Divizionit për Burime Njerëzore në Agjencinë e punësimit; Njoftimi me numër të protokollit 772 të datës 16.12.2022 të Zv. Udhëheqëses së Divizionit për Burime Njerëzore; Njoftimin me numër të protokollit 739 të datës 07.12.2022 të Zv.Udhëheqëses së Divizionit për Burime Njerëzore; Konkursin me numër të referencës RN00010303 të datës 03.11.2022; Vërtetimin me numër të protokollit 716 të datës 29.11.2022; Vërtetimin me numër të protokollit 716 të datë 20.11.2022; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në punë të punës të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulet dhe profesional për vitin 2021; Formularin për vlerësimin rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulet dhe profesional për vitin 2022; Akt emërimit me numër të protokollit 15 të datës 22.01.2015; Dokumentin e identifikimit të ankuesit; Diplomën universitare me numër 237/1012 të datës 10.10.2012; Certifikatën e datës 24.07.2014 lidhur me përfundimin e studimeve universitare të lëshuar nga Prof.Asoc.Dr. Pasqyrën e notave të datës 31.03.2016; Rekomandimin e datës 30.04.2016 të lëshuar nga Asisst. Prof. Dr.. Certifikatën lidhur me pjesëmarrjen në konferencën “Challenges” të datës 27.11.2021; Shkresën e datës 18.02.2020; Shkresën e datës 22.12.2020 lidhur me shkollën e biznesit EBAF; Shkresën e datës 20.06.2022; Shkresën lidhur me pjesëmarrjen në kongresin Botëror të investitorëve Engjëllit për periudhën kohore 25-26.10.2022; Shkresën e datës 22.12.2020; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit Menaxhimi Strategjik dhe Projekti për periudhën kohore 22-24.05.2019; Certifikatën e datës 26.02.2019 lidhur me pjesëmarrjen me sukses të trajnimit shtat javor “ Leadership dhe të folurit në publik”; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit “ Today’s Diplomat V-The Strategies Of a successful Diplomacy” të mbajtur me datën 07.12.2018; Certifikatën e lëshuar në Dhjetor 2018 lidhur me përfundimin e trajnimit “ Kontabiliteti dhe Legjislacioni i ri tatimor deklarata vjetore dhe pasqyrat financiare”, Procedurat e Aplikimit dhe marrjes së granteve dhe Subvencioneve”; Certifikatën (pa date dhe numër) me të cilën vërtetohet se ankuesi ka përfunduar me sukses trajnimin për shkathesit dhe njohurit themelore për të trajtuar grupet shoqërore në disavantazh; Certifikatën lidhur me përfundimin me sukses të trajnimit intensiv (16) ore në “ Menaxhimi i Financave nga Menaxheret” në periudhën 06-07.04.2013; Emalin e datës 10.02.2023 të drejtuar KPMSHCK-se; Emalin e datës 10.02.2023 të drejtuar KPMSHCK-së; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 1931/2023 të datës 20.02.2023; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 2158/2023 të datës 28.02.2023; Vendimin me numër të protokollit 754 të datës 12.12.2022 për Themelimin e Komisionit Vlerësues për Lëvizje Brenda Kategorisë të Zv. Drejtorit të Përgjithshëm / APRK; Aplikacionin e datës 29.11.2022 të ankuesit; Vërtetimin me numër të protokollit 716 të datës 29.11.2022 lidhur me përvojën e punës së ankuesit; Vlerësimet e anëtarëve vlerësues lidhur me intervistën me gojë (pa date dhe numër); Renditja përfundimtare e kandidateve e datës 27.12.2022; Diplomën me numër 0014.011 të datës 07.06.2000 lidhur me përfundimin e shkollës së mesme; Pasqyrën e notave të datës 31.03.2016 të lëshuar nga kolegji Fama; Certifikatën e datës 27.11.2021 lidhur me pjesëmarrjen në konferencën “Shallengës dhe Effects of Justice Reform in the Justice System”;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është ushtruar jashtë afatit ligjor, sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës Kolegji ka konstatuar se Agjencia e Punësimit përmes SIMBNJ-së ka publikuar më datë 03.11.2022 Konkursin për lëvizje brenda kategorisë më numër reference RN00010303 për pozitën e punës Zyrtar për Shërbime të Punësimit, klasa profesional 2, e në të cilin konkurs kishte aplikuar vetëm një kandidat në këtë rast ankuesi. I njëjti në fazën e shqyrtimit paraprak ishte vlerësuar si kandidat që plotëson kushtet për lëvizje në kategori si dhe kushtet për pozitën e shpallur, mirëpo, sipas vlerësimit përfundimtar të Komisionit për lëvizje brenda kategorisë (tutje Komisioni i Vlerësimit) i themeluar sipas Vendimit me numër protokollit 754 të datës 12.12.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Punësimit, kishte arritur vetëm 57.4 pikë të vlerësimit, të pamjaftueshme për t'u shpallur si kandidat i suksesshëm, kështu që organi përkatës i punësimit ka përfunduar procedurën e pranimit pa kandidat fitues.

I pakënaqur me vlerësim përfundimtar të Komisionit të Vlerësimit, ankuesi parashtron ankesë të brendshme të Komisioni Vlerësues, ndërsa kjo e fundit më Vendimin me numër të protokollit 10 të datës 06.01.2023 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar.

Kundër Vendimit me numër të protokollit 10 të datës 06.01.2023 të Komisionit të Vlerësimit, ankuesi parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më pretendimet se Komisioni i Vlerësimi nuk ka bërë vlerësim të drejtë, dhe se ankuesi ushtron po këtë pozitë të punës vetëm në një lokacion tjetër.

Në kuptim të plotësimit të kushteve për pranueshmerinë e ankesës, Kolegji i Këshillit bazuar në shqyrtimin e shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesi vendimin e kundërshtuar me ankesë përkatësisht Vendimit me numër të protokollit 10 të datës 06.01.2023 të Komisionit të Vlerësimit e ka pranuar me datë 10.01.2023, në formë fizike përmes nënshkrimit të vet vendimit të kundërshtuar, ndërsa ankesën lidhur me kundërshtimin e ligjshmërisë së këtij vendimi e ka parashtruar në Këshill më datë 10.02.2023, pra në ditën e 31-të, kështu që mbi këtë fakt, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankuesit *me shenjë A.347/2023, është parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili shprehimisht përcakton: "Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve , nga data kur është njoftuar për aktin administrativ".*


Kolegji, po ashtu mori parasysh dispozitat e nenit 81 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative lidhur me llogaritja e afateve, me të cilat është përcaktuar se: 1. *Përveç kur parashikohet ndryshe me ligj, afatet do të përcaktohen në ditë, muaj apo vite. Mbarimi i afatit mund të përcaktohet edhe me një datë të caktuar kalendarike.* 2. *Kur afati përcaktohet në ditë, në llogaritjen e tij përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja nga e cila fillon të ecën afati..."*

Andaj, nisur nga konstatimet si me lartë, Kolegji në mbështetje të nenit 129 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi që ankesa e ankuesit të hedhet poshtë si e palejuar.


Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e anëshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda më numër A.nr.347/2023

Ilire Mehmeti-Shaqiri


Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesi
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Punësimit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

